

VENDIM
Nr. 772, datë 13.12.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 869, DATË 18.6.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7889, DATË 14.12.1994, ‘STATUSI I INVALIDIT’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 869, datë 18.6.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, ‘Statusi i invalidit’, të ndryshuar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Shtesa mujore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, indeksohet në të njëjtën mënyrë dhe përqindje si pensionet, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

1/2. Shtesa mujore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përjashtimisht për vitin 2025, indeksohet sipas indeksit të parashikuar në vendimin nr. 582, datë 18.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për indeksimin e pensioneve”.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shtesa mujore e invalidit paguhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore së bashku me pensionin e invaliditetit apo të pleqërisë, në qendrat paguese të Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, sipas kërkesës së përfituesit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku